

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Rrezarta Lleshaj, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.K. nga Prishtina, për shkak të veprës penale vrasje nga neni 146 të KPK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, dhe të miturit J.K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore – DKR në Prishtinë, mbrojtësve të akuzuarit K.K., av. V.V. dhe av. R.G., dhe mbrojtësit të miturit J.K., av. R.K., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.736/2015, të datës 09.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, më datë 05.05.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me pranimin e pjesërisht të ankesës së mbrojtësve të akuzuarit K.K., NDRYSHOHET, aktgjykimi i Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.736/2015, të datës 09.12.2016, vetëm për vendimin për dënim, përkitazi me të akuzuarin K.K., ashtu që, Gjykata e Apelit, për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor, dënimin e shqiptuar me gjobë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, nga gjykata e shkallës së parë, e merr si të vërtetuar, ndërsa, për veprën penale vrasje nga neni 146 të KPK-së, të akuzuarin e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vjetësh, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe atë nga dt. 23.09.2011 e tutje.

Ankesa e Prokurorisë Themelore –DKR në Prishtinë, mbrojtësit të miturit J.K., si dhe ankesa e përbashkët e mbrojtësve të akuzuarit K.K., për bazat tjera ankimore, refuzohen si të pabazuara.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, me aktgjykimin, PKR.nr.736/2015, të datës 09.12.2016, e ka shpallur fajtorë të akuzuarin K.K., për vepër penale vrasje nga neni 146 të KPK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 të KPK-së dhe për këto vepra penale e ka gjykuar, për veprën penale vrasje nga neni 146 të KPK-së, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) vjetësh, në të cilin i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim, nga data 23.09.2011, dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, me dënim me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) €, të cilin dënim është i detyruar ta paguajë në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarin e ka detyruar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të shumës së paushallit gjyqësor, shumën prej 200 (dyqind) €, të gjitha në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Me aktgjykimin e ankimuar të miturit J.K., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, i është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë në kohëzgjatje prej 1(një) viti.

Shpenzimet procedurale përkitazi me të miturin kanë mbetur barrë e mjeteve buxhetore të gjykatës.

Të dëmtuarin A.K., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Bazuar në dispozitat e nenit 69 të KPK-së, të akuzuarit dhe të miturit i është shqiptuar dënimi plotësues-konfiskimi, ashtu që janë konfiskuar një revole e prodhimit gjerman kal.380 Knall dhe 6 fishekë me mulli dhe revolja e tipit M-57, kal.7.62 mm, C-58950, me një fishekë në tytë dhe një karikator me 7 fishekë, si mjete me të cilat është kryer vepra penale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

-Prokuroria Themelore-DKR në Prishtinë, për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit K.K., t'i shqiptojë një dënim më të lartë me burgim.

-Mbrojtësit e të akuzuarit K.K., av. R.G. dhe av. V.V., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që i akuzuari të

lirohet nga akuza, apo aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Mbrojtësi i të miturit J.K., av. R.K., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorinë e Apelit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm i dëmtuari A.K., i akuzuari K.K. dhe i mituri J.K., mbrojtësit e të akuzuarit, av. V.V. dhe R.G. dhe mbrojtësi i të miturit J.K., av. R.K., ndërsa edhe pse të njoftuar në mënyre të rregullt nuk prezantoi askush nga Prokuroria e Apelit. I dëmtuari A.K. në seancën e kolegjit i propozoi gjykatës që në këtë çështje penale juridike të vendos në bazë të drejtësisë dhe ligjit, ndërsa, mbrojtësit e të akuzuarit K.K., av. V.V. dhe R.G., pasi më parë sqaruan disa nga pretendimet ankimore, ngelën në terësi pranë propozimeve si në ankesë, të cilët, po ashtu, i përkrahen i akuzuari K.K. dhe i mituri J.K..

Prokuroria e Apelit, me parashtresën, PPA/I.nr.175/2017, të dt. 05.04.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë, të aprovohet, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit K.K., t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim, ndërsa ankesat e mbrojtësve të akuzuarve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesat e Prokurorisë Themelore – DKR në Prishtinë, mbrojtësit e të miturit J.K., nuk janë të bazuara, ndërsa, ajo e mbrojtësit të akuzuarit K.K., pjesërisht është e bazuar.

Pretendimet ankimore përkritazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Në ankesën e përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit K.K., av. V.V., dhe av. R.G., përkritazi me këtë bazë ankimore, pretendohet se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nën par.12 e lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK-së, ngase, dispozitivi i aktgjykimin të ankimuar është i pa kqartë, kundërthënës dhe atë përveç në brendinë e tij edhe me vetë arsyetimin. Gjithashtu, sipas pretendimeve ankimore dispozitivi i aktgjykimin të ankimuar, është aq konfuz, i pa qartë e kontradiktor me arsyetimin, saqë i njëjti edhe nuk mund të ekzaminohet, ngase, derisa në këtë çështje penale-juridike bëhet fjalë për faktin se familja K. ka qenë e sulmuar, gjykata e shkallës së parë, konstaton krejt diçka tjetër- pra, duke konstatuar se të akuzuarit A.K.2, N.D. dhe tani i

ndjeri A.K.2, kanë shkuar për të biseduar, gjë që, nuk përputhet fare me gjendjen reale që ka ndodhur ditën kritike dhe atë duke u bazuar, përveç deklaratës së dëshmitarit edhe në provat materiale në shkresat e lëndës. Pastaj, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim me vetëveten, ngase, derisa, në dispozitiv tek emërtimi ligjor i veprës penale, konstatohet se i akuzuari ka kryer veprën penale vrasje e rëndë nga neni 146 par.4 të KPPK-së, nga dispozita e Kodit Penal të Kosovës, pra, kur është fjala tek neni 146, vepra penale nuk ka fare par. 4, ku përcaktohet vrasja- pra është fjala për vrasje të rëndomtë e jo të rëndë, që do të thotë se tani mbetet e paqartë se i akuzuari për çfarë vepre penale është shpallur fajtor për vrasje të rëndomtë apo vrasje të rëndë, sikur që ka qenë edhe i akuzuar nga prokuroria me aktakuzë.

Pastaj, po ashtu, në rastin konkret, në aktgjykimin e ankimuar, arsyet e dhëna për faktet vendimtare janë kundërthënëse dhe atë sidomos me përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve të deklaratave të dhëna në procedurë në këtë çështje penale-juridike, gjegjësisht në arsyetim nuk janë dhënë fare arsyet për faktet vendimtare, ndërsa, ato pak arsye që janë dhënë janë në kundërshtim të plotë me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, sidomos është për t'u cekur fjala përfundimtare e mbrojtësve të akuzuarit K.K., ku nuk janë marrë parasysh fare pretendimet e mbrojtjes të paraqitura në fjalën përfundimtare, pra, gjykata e shkallës së parë, ka dështuar të jap një analizë dhe vlerësim të mirëfilltë të pretendimeve të mbrojtjes, por vetëm ka paraqitur konkludimet e saja duke mos u mbështetur fare në deklaratat e dëshmitarëve, por as provat materiale, gjë që, të gjitha këto paraqesin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par. 12 e lidhur me dispozitat e nenit 370 par. 6 e 7 të KPPK-së. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, po ashtu gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë vlerësimin e saj për faktete vendimtare, por vetëm ka bërë përshkrimin e deklaratave të dëshmitarëve, duke paraqitur kështu përmbajtjen e tyre, pra të deklaratave të dëshmitarëve, por pa dhënë vlerësimin real të tyre, duke e bërë pra, krahasimin e deklaratave e sidomos të atyre kundërthënëse, e pastaj të paraqes vlerësimin e saj, pastaj nuk është marrë fare parasysh propozimi për rikonstruimin e vendit të ngjarjes, ku nga ky veprim procedural do të mund të vërtetohej shumë më lehtë gjendja faktike, e cila edhe ashtu nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe atë pikërisht për shkak të mangësisë së provave në shkresat e lëndës. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë, përveç në dispozitiv, sikur që u cekë më lartë lëshime të njëjta procedurale ka bërë edhe në arsyetim, sidomos kur konstaton se "i akuzuari K.K., ka kryer veprën penale të vrasjes nga neni 146 të KPK-së, duke konstatuar se një gjë e tillë vërtetohet nga deklarata e dëshmitarit A.K.2", deklaratë kjo e cila nuk e vërteton një gjë të tillë, ndërsa, deklarata e dëshmitarit në fjalë e dt.23.09.2011, të cilën gjykata e shkallës së parë, e ka shpallur të papranueshme, nuk merret fare parasysh, kur dëshmitari në fjalë gjatë dhënies së deklaratës tjetër në prokurori, me dt. 12.10.2011, deklaroi se të njëjtën gjë sikur që ka deklaruar në polici, gjë që, gjykata e shkallës së parë, fare nuk e merr parasysh rrethanën në fjalë, edhe pse dëshmitari deklaroi se qëndron në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici. Gjukata e shkallës së

parë, po ashtu, ka dështuar në dhënien e vlerësimit të saktë të deklaratave të dëshmitarëve në këtë çështje penale-juridike, e sidomos të dëshmitares V.H., ku nga deklarata në fjalë i merr vetëm disa pjesë të deklaratës dhe e bënë interpretimin e sajë–pra, pjesë–pjesë, pra, duke paraqitur edhe analizën e vetëm të disa pjesëve të deklaratës në fjalë, por nuk e merr deklaratën në fjalë në tërësi- pra të plotë, dhe pastaj të jap konkludimet e saja, natyrisht pasi më parë ta bëjë krahasimin e sajë me përmbajtjen e deklaratave të dëshmitarëve të tjerë, por edhe me përmbajtjen e provave materiale në shkresat e lëndës, e sidomos në ekspertizën mjeko ligjore dhe atë të balistikës. Gjykata e shkallës së parë, po ashtu, edhe përkundër propozimit të mbrojtjes nuk pranoi që ta bëjë edhe njëherë rikonstruimin e vendit të ngjarjes dhe në mënyrë të plotë të vërtetohet gjendja faktike, por apriori e refuzoi një propozim të tillë, edhe përkundër kundërthënieve dhe konfuzitetit që ekziston në mes të deklaratave të dëshmitarëve, por edhe provave materiale në këtë çështje penale-juridike. Po ashtu, me aktgjykimin e ankimuar nuk janë marrë fare parasysh deklaratat e dëshmitarëve Sh.K., M.K. dhe A.K., ku nga përmbajtja e këtyre deklaratave në shkresa të lëndës, rezulton se nuk arrihet ajo që e dëshiron gjykata, prandaj, edhe nuk paraqet fare analizën dhe vlerësimin e deklaratave në fjalë, por përkundrazi krejt arsyetimin ia kushton deklaratës së dëshmitarit A.K.2 dhe atë duke mos marrë fare parasysh kundërthëniet dhe kontradiktoritetin me deklaratat tjera të dëshmitarëve, por edhe me provat materiale, e sidomos ekspertizën mjeko ligjore dhe atë të balistikës, pra pa bërë fare krahasimin dhe vlerësimin e deklaratës në fjalë me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, por edhe provave materiale në shkresat e lëndës, por apriori konstaton se është vërtetuar gjendja faktike në bazë të deklaratës së këtij dëshmitari, për çka edhe pastaj, të akuzuarin edhe e ka shpallur fajtor për vepër penale si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, duke bërë kështu shkelje esenciale nga dispozitat e nenit 262 të KPPK-së, ngase, i akuzuari, sipas dispozitave në fjalë, nuk mund të shpallet fajtor duke u mbështetur vetëm në deklaratën e të bashkakuzuarit, sikur që ka vepruar në rastin konkret gjykata e shkallës së parë. Ndërsa, mbrojtësi i të miturit J.K., av. R.K., përkritazi me këtë bazë ankimore, konstaton se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 365 par.1 nën par.1 dhe 5 dhe neni 370 par.6 dhe 7 të KPPK-së, ngase, aktgjykimi nuk është përpiluar konform dispozitave të nenit 365 të KPPK-së, ku kërkohet shprehimisht që në dispozitiv të shënohet vepra penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe atë së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, gjë që, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka dështuar ta bëjë një gjë të tillë, prandaj, edhe propozon që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje edhe për të miturin J.K..

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e lartë cekura ankimore janë të pabazuara nga se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i

ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara, nga neni 384 par.1 nën par.12 e lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK, ngase, dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, ku pra në dispozitiv janë përshkruar të gjitha veprimet inkriminuese të akuzuarit K.K., që përbëjnë elementet e veprës penale të vrasjes nga neni 146 të KPK-së, ndërsa, sa i përket emërtimin ligjor të veprës penale, ku konstatohet vrasje e rëndë nga neni 146 par. 4 të KPK-së, haptazi vërehet se është fjala për gabim teknik, ngase nga përmbajtja e arsytimit të aktgjykimit të ankimuar në mënyrë të qartë rezulton se gjykata e shkallës së parë, ka bërë ri cilësimin e veprës penale nga vrasje e rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 4 të KPK-së, në vrasje nga neni 146 të KPK-së, mirëpo, në dispozitiv gabimisht ka mbetur par. 4 dhe fjala vrasje e rëndë, gjë që lëshimet në fjalë të natyrës krejtësisht teknike nuk e vejnë dispozitivin në kundërshtim me vetë veten e as me emërtimin ligjor të veprës penale, sikur që pretendohet në ankesë, sidomos, kur një gjë e tillë edhe në arsyetim është qartësuar në detaje sepse gjykata e shkallës së parë, ka bërë ri cilësimin e veprës penale në fjalë. Po ashtu, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar përveç që nuk është në kundërshtim me vetë veten, i njëjti është plotësisht në përputhshmëri të plotë edhe me arsytimin, ngase, faktet dhe rrethanat e përshkruara në dispozitiv gjejnë mbështetje, përveç në deklaratën e dëshmitarit A.K.2-dëshmitar okular në vendin e ngjarjes, edhe në deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, por edhe në provat materiale, e konkretisht ekspertizën mjeko-ligjore dhe atë të balistikës, si dhe procesverbalin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes. Prandaj, nuk ka as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara sipas nenit 262 të KPPK-së, ngase, në rastin konkret aktgjykimi i ankimuar nuk mbështetet vetëm në deklaratën e të bashkakuzuarit, por as në të vetmen dëshmi-pra, vetëm në deklaratën e dëshmitarit A.K.2, ngase, tani ish i akuzuari A.K.2, në seancën e shqyrtimit gjyqësor – pra, në rigjykim ka dhënë deklaratë në cilësinë e dëshmitarit e jo të akuzuarit, ngase, procedura penale për të akuzuarin A.K.2, ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë – pra, është refuzuar aktakuza për shkak të parashkrimit të veprës penale, nga Gjykata e Apelit, me aktvendimin e mëparshëm, kur çështja penale në fjalë është kthyer në rigjykim dhe tani ish i akuzuari A.K.2, është marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitarit, deklaratë kjo e cila nuk është dëshmi e vetme në rastin konkret nga e cila është vërtetuar gjendja faktike. Po ashtu, në arsytimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penalo juridike, po ashtu, janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par.2 të KPPK, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par.7 të KPPK, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyerash i merr si të provuara ose si të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, pra ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe mbrojtjen e të akuzuarit, i cili e mohon kryerjen e veprës penale me arsyetim se nuk ka qenë fare në vendin e ngjarjes, se familja K., ka qenë e sulmuar nga tani i ndjeri A.K.2 dhe vëllai i tij A.K.2 dhe atë së bashku edhe me shumë persona të tjerë dhe se familja K., është dashur që të mbrohet nga sulmi i

familjes Kastrati, fakte këto dhe rrethana që gjykata e shkallës së parë, i ka marrë parasysh, por i ka vlerësuar si të pabazuara dhe atë duke e bazuar vlerësimin e saj në deklaratën e dëshmitarit okular A.K.2, por edhe dëshmitarit tjetër F.S., i cili ka qenë në vendin e ngjarjes duke punuar si roje e parkingut-dëshmitar ky, pra, që nuk është i familjes K., pastaj, dëshmitarëve tjetër-policëve të PK-së, ku për dëshmitaren V.H., gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysh edhe deklaratat kundërthënëse të saj-pra, atë të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, por që e ka krahasuar edhe me deklaratën e dhëna në fazat e më hershme të procedurës dhe duke e krahasuar deklaratën në fjalë me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, por edhe me provat materiale, ka konkluduar se deklarata e parë e kësaj dëshmitareje është e drejtë dhe objektive, e në bazë të së cilës edhe ka vërtetuar gjendjen faktike, pra, duke e ndërlidhur të njëjtën me provat tjera në shkresat e lëndës, fakte këto dhe rrethana që gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe nga ekspertizat e ekspertëve të balistikes dhe atyre mjeko-ligjor dhe lidhur me to edhe i ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Prandaj, qasja ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme as një fakt nuk ka ngelur i pavërtetuar dhe përveç që janë vërtetuar drejtë ato edhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë. Kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe po ashtu edhe përkitazi me pretendimin e të akuzuarit se nuk ka qenë fare në vendin e ngjarjes, ku gjykata e shkallës së parë, në bazë të deklaratës së dëshmitares V.H., të dhënë në polici ka vërtetuar se në vendin e ngjarjes ka qenë i akuzuari K.K., ndërsa, në bazë të deklaratës së dëshmitarit A.K.2, po ashtu edhe të dëshmitares-polices Fahrije Lutfiu, ka vërtetuar se pikërisht i akuzuari K.K., është personi që ka privuar nga jeta tani të ndjerin A.K.2, deklarata këto, sidomos, ajo e dëshmitarit A.K.2, që kanë mbështetje edhe në provat materiale-procesverbalin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes, por edhe ekspertizat mjeko-ligjore dhe atë të balistikës. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysh edhe pretendimin e të miturit J.K., se ka qenë i sulmuar nga tani i ndjeri A.K.2 dhe vëllai i tij-dëshmitari A.K.2, së bashku me persona të tjerë, por pretendimet në fjalë i ka vlerësuar si të pabazuara dhe atë duke marrë parasysh së pari deklaratën e dëshmitarit A.K.2, i cili deklaroi se ditën kritike i mituri J.K. e ka provokuar më parë tani të ndjerin A.K.2, duke e thirrur që të bisedojnë për problemet e tyre, ndërsa nga deklarata e dëshmitarit tjetër F.S., se tek familja K., kanë shkuar tani i ndjeri A.K.2 së bashku edhe me vëllain A.K.2n dhe disa persona tjerë dhe atë në drejtim të të miturit J.K., ku menjëherë ka filluar përleshja fizike në mes tyre, e pastaj, ka pasur edhe të shtëna armësh dhe se në vendin e ngjarjes përveç të miturit kanë qenë edhe i akuzuari K.K. dhe Sh.K., prandaj, edhe me të drejtë është konstatuar se i akuzuari K.K., ka qenë në vendin e ngjarjes, që do të thotë se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme edhe përkitazi me pretendimin në fjalë, sidomos kur merren parasysh, përveç deklaratave të dëshmitarëve edhe mendimet e eksperteve të balistikes dhe atyre mjeko-ligjore, për çka më në detaje do të flitet gjatë elaborimit të bazës ankimore përkitazi me gjendjen faktike.

Po ashtu, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe përkritazi me propozimet e refuzuara të palëve, dhe atë sidomos për propozimin e mbrojtjes për rikonstruimin e vendit të ngjarjes, ku gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar në arsyetim se rikonstruimi i vendit të ngjarjes është bërë dy herë radhazi dhe pasi që ka konstatuar se të gjitha palët kanë qëndruar pranë deklaratave të tyre të dhëna në rikonstruimin e mëparshëm të vendit të ngjarjes, gjykata ka konstatuar se nuk është e nevojshme që të përsëritet prapë rikonstruimi i vendit të ngjarjes, gjë që, një vlerësim të tillë e pranon edhe kjo gjykatë, ngase, edhe ashtu gjendja faktike është vërtetuar dhe atë sidomos kur merren parasysh deklaratat e dëshmitarëve dhe provat materiale, por edhe deklaratat e ekspertëve të balistikës dhe atyre mjeko-ligjore, të cilët kanë plotësuar ekspertizat e tyre në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Përkritazi me këtë bazë ankimore, - pra, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, edhe pretendimet e mbrojtësit të mituri J.K., av. R.K., nuk qëndrojnë, ngase, duke pasur parasysh se për të miturit parashihet procedurë e veçantë e që rregullohet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, atëherë i mituri nuk shpallet fare fajtor për vepër penale, por vetëm konstatohet vepra penale që është kryer dhe të miturit i shqiptohet masa, kështu që sa i përket dispozitivit gjykata e shkallës së parë, nuk ka aplikuar dispozitat e KPPK, por të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, e që do të thotë se në rastin konkret nuk ka qenë e obliguar të veprojë konform dispozitave të nenit 365 të KPPK, sikur që pretendohet në ankesë. Po ashtu edhe sa i përket arsyerave për faktet vendimtare për të miturin, gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe atë bazuar në deklaratat e dëshmitarëve-policëve të PK, kur edhe vërtetohet se i mituri ditën kritike ka poseduar armë të cilën, me të arritur policia në vendin e ngjarjes e ka hudhur, ku po ashtu përmes ekspertizës është vërtetuar se e njëjta nuk është përdorur, por vetëm ka qenë në posedim nga i mituri, për çka, pastaj edhe i është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë, ku po ashtu gjykata e shkallës së parë, për shqiptimin e masës në fjalë, ka marrë parasysh të gjitha kushtet dhe rrethanat që duhet të plotësohen për shqiptimin e masës në fjalë, pra, ka marrë parasysh raportin me shkrim të shërbimit sprovues dhe në bazë të gjendjes së konstatuar për të miturin, i ka shqiptuar masën e mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë, prandaj, edhe nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sikur që pretendohet në ankesë.

Pretendimet ankimore përkritazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe gjetjet e gjykatës.

Përkritazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, në ankesë në esencë kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nga ana e gjykatës së shkallës së parë, si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë në bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, prandaj, edhe përfundimet kanë pasuar të gabuara, pa mbështetje në prova, për çka të akuzuarin, është dashur ta lirojë nga akuza, ngase, veprën

penale të vrasjes e ka kryer i mituri J.K., dhe atë në mbrojtje te nevojshme, gjë që e përjashton përgjegjësinë penale, e jo sikur që ka vepruar gjykata e shkallës së parë, duke e shpallur fajtor të akuzuarin K.K., për vepër penale të vrasjes nga neni 146 të KPK-së. Kjo për arsye se, gjithëherë sipas pretendimeve ankimore, gjykata e shkallës së parë, me asnjë provë në shkresat e lëndës, nuk e ka vërtetur se i akuzuari K.K., ka privuar nga jeta tani të ndjerin A.K.2, ndërsa, nga deklarata e dëshmitarit Sh.K., të akuzuarit K.K., dëshmitarët M.K. dhe të miturit J.K., vërtetohet se ditën kritike familja K., ka qenë e sulmuar nga tani i ndjeri A.K.2, vëllai i tij A.K.2, dëshmiari N.D. dhe së bashku me një grup tjetër të personave, dhe pasi plagoset dëshmitari Sh.K., i mituri J.K., i cili ishte vetëm një metër larg Sh.K.t, i gjendur pa dashje në situatën “Gjuaj ose vdis” ka shtënë në drejtim të tani të ndjerit A.K.2 dhe atë dy herë radhazi, ku nga plagët e marra tani i ndjeri A.K.2 vdes në vendin e ngjarjes, fakte këto dhe rrethana që vërtetohen edhe përmes provave materiale, si raporti i autopsisë, ekspertiza mjeko-ligjore, ekspertiza e balistikës, raporti i këqyrjes në vendin e ngjarjes, procesverbali i rikonstruimit të vendit të ngjarjes si dhe foto dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë, prandaj, gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit K.K., kur e ka shpallur fajtor për vepër penale vrasje nga neni 146 të KPK-së.

Gjykata e Apelit, konstaton se, pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë, ngase me pa mëdyshje, pra, edhe nga vetë mbrojtja e të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar faktin dhe rrethanat se ditën kritike në parkingun e ish “Ramiz Sadiku”, ku ishin duke punuar familja K. – pra, në pronën e tyre, kanë shkuar tani i ndjeri A.K.2, me vëllain e tij - dëshmitarin A.K.2 dhe dëshmitarin tjetër N.D., ku pas një fjalosje në mes tyre, ka filluar edhe konflikti fizik, për çka lëndime të rënda trupore pësojnë dëshmitari Sh.K., ndërsa, nga të shtënat me armë në vendin e ngjarjes mbetet i vdekur tani i ndjeri A.K.2, kurse, nga përlëshja fizike lëndime të lehta trupore pësojnë dëshmitari A.K.2 dhe N.D..

Ndërsa, përkitazi me faktet kontestuese se kush e privoi nga jeta tani të ndjerin A.K.2, gjykata e shkallës së parë, së pari ka dëgjuar dëshmitarin A.K.2, i cili deklaroi se ditën kritike pasi më parë ka shkuar me vëllain e tij A.K.2n, në punishten – parkingun e ish “Ramiz Sadiku”, ku gjendeshin i akuzuari K.K., i mituri J.K., dhe dëshmitari Sh.K., me t’u futur në punishten e tyre, pas një konflikti verbal në mes tyre ka filluar edhe përlëshja fizike, ku pasi më parë e kanë rrahur të dëmtuarin A.K.2 dhe tani të ndjerin A.K.2, për një moment i akuzuari K.K., e ka nxjerrë revolen dhe ka shtënë në tani të ndjerin A.K.2 dhe atë dy herë radhazi në shpinë, ku pas plagëve që pëson tani i ndjeri ka mbetur i vdekur në vendin e ngjarjes. Faktet dhe rrethanat në fjalë, po ashtu, pjesërisht i vërteton edhe dëshmitari N.D., i cili deklaroi se me të arritur aty afër vendit të ngjarjes kur në oborrin e parkingut të ish “Ramiz Sadiku”, janë futur dëshmitari A.K.2 dhe tani i ndjeri A.K.2, dhe në drejtim të tyre kanë shkuar tre persona të cilët menjëherë e kanë sulmuar të dëmtuarin A.K.2 dhe tani të ndjerin A.K.2, ndërsa, menjëherë aty në hyrje të oborrit disa persona të tjerë e kanë sulmuar e pastaj edhe rrahur dëshmitarin N.D., të cilit i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore. Ndërsa, nga deklarata e dëshmitarit F.S., i cili ka qenë roje e parkingut

në vendin e ngjarjes – pra, dëshmitar okular i vendit të ngjarjes, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se ditën kritike në oborrin e parkingut të ish “Ramiz Sadikut”, ku po punonte familja K., ka vërejtur kur në drejtim të akuzuarit K.K., të miturit J.K., dhe dëshmitarit M.K., të cilët po qëndronin aty pari-para lokaleve ku kanë qenë duke punuar, po vinin tani i ndjeri A.K.2, vëllai i tij A.K.2 dhe 4-5 persona të tjerë dhe me tu ofruar njëri me tjetrin, menjëherë ka filluar përlëshja fizike në mes tyre, ku pas një përlëshje shumë të shkurtë janë dëgjuar edhe të shtëna armësh, pastaj, ka vërejtur se i vdekur në vendin e ngjarjes ka mbetur tani i ndjeri A.K.2, kurse i plagosur dëshmitari Sh.K.. Ndërsa, nga deklarata e dëshmitares – polices së PK-së, V.H., e cila në vendin e ngjarjes ka ardhur menjëherë pas dëgjimit të shtënave, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se në vendin e ngjarjes e ka gjetur të akuzuarin K.K., i cili në momentin e arritjes së dëshmitares, ka qenë duke ikur nga vendi i ngjarjes- pra, i kthyer me shpinë nga dëshmitarja, e cila duke e përdorur armën e ka ndaluar të akuzuarin dhe e ka detyruar që të qëndrojë në vendin e ngjarjes, gjegjësisht, me dëshmitarën tjetër F.L.- po ashtu, police e PK-së. Ndërsa, nga dëshmitarja në fjalë, F.L., gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se pas një qëndrimi të shkurtë në vendin e ngjarjes i akuzuari ka kërkuar nga policja që t’i lejohet që ta dërgojë vëllain e tij Sh.K., të plagosur në vendin e ngjarjes, për ndihmë mjekësore në Spitalin e QKUK-së, për çka, dëshmitarja nuk e ka lejuar, por, për një moment duke e shfrytëzuar rastin i akuzuari e ka futur të plagosurin Sh.K., në një kombi-Bus dhe e ka dërguar në lokalet e Spitalit të QKUK-së. Po nga deklarata në fjalë vërtetohet se dëshmitarja F.L., me një automjet tjetër ka shkuar tek lokalet e QKUK-së, dhe në momentin kur po qëndronte në korridoret e spitalit dhe kur i akuzuari K.K., është ngritur në këmbë dhe ka dashur të dal nga lokalet e spitalit për ta larguar automjetin nga rruga, kuptohet, me ftesën e personelit të Spitalit, dëshmitari A.K.2, i cili po ashtu, gjendej në lokalet e spitalit në fjalë, ka deklaruar se ky është personi që ka vrapë vëllain tim, ku pastaj, dëshmitarja F.L. ka arrestuar të akuzuarin K.K., dhe kanë filluar procedura të mëtutjeshme përkitazi me vrasjen në fjalë. Faktet dhe rrethanat në fjalë, gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe përmes provave materiale ku nga ekspertiza mjeko-ligjore është vërtetuar se tani i ndjeri është qëlluar me armë zjarri dhe atë në anën e majtë të shpinës, një goditje tjetër pas veshi, dhe një goditje tjetër në krahun e majtë, nga të cilat lëndime tani i ndjeri vdes në vendin e ngjarjes, fakte këto dhe rrethana, në bazë të cilave, bazuar edhe në mendimin e ekspertizës së balistikës, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se pozita e tani të ndjerit me kryesin e veprës penale në momentin kritik nuk ka qenë ballë për ballë, por, i akuzuari ka shtënë prapa tani të ndjerit – pra, e ka goditur nga prapa që do të thotë se nuk mund të flitet për mbrojtje të nevojshme sikur që pretendohet në ankesë. Ndërsa, nga ekspertiza e balistikës vërtetohet se në bazë të gëzhgojave të gjetura në vendin e ngjarjes, por edhe armës, e cila është vërtetuar se i ka takuar të miturit J.K., është vërtetuar se nuk është përdorur fare nga i mituri J.K., gjë që, faktet dhe rrethanat në fjalë janë vërtetuar edhe përmes ekspertizës tjetër të krim-teknikës ku nga mostrat e marra nga duart e të miturit J.K., është vërtetuar se i mituri J.K., nuk ka përdorur fare armën ditën kritike, gjë që, po ashtu, sipas ekspertëve në fjalë- pra, të balistikës, duke pasur parasysh vendin ku ka qëndruar i mituri J.K., sipas procesverbalit të rikonstruimit të vendit të ngjarjes, po ashtu, është

konstatuar se nuk ka pasur mundësi që i mituri J.K., të ketë shtënë me armë në tani të ndjerin A.K.2. Po ashtu, është me rëndësi të konstatohet nga gjykata e shkallës së parë, përmes ekspertizës tjetër të dt. 22.03.2012, është vërtetuar se tek dëshmitarët Sh.K., N.D., A.K.2 dhe i mituri J.K. si dhe tani i ndjeri A.K.2, nuk janë gjetur fare grimca të barotit që do të thotë se këta pjesëmarrës të ngjarjes në ditën kritike nuk kanë përdorur fare armë, prandaj, edhe nuk mund të qëndrojë pretendimi se i mituri J.K., ka shtënë në tani të ndjerin A.K.2, sikur që pretendohet në ankesë.

Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, i drejtë dhe plotësisht i arsyeshëm dhe i bazuar në ligj, është konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, kur konstaton gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ngase, pasi fillon konflikti verbal e pastaj edhe fizik, në mes pjesëtarëve në mes të dy familjeve K. dhe Kastrati, dhe atë pasi më parë e rrahin tani të ndjerin A.K.2 dhe dëshmitarin A.K.2, i akuzuari K.K., me armë të tipit të panjohur nga prapa – pra, pas shpine ka shtënë në tani të ndjerin A.K.2n, duke i shkaktuar kështu plagë vdekjeprurëse i cili edhe vdes në vendin e ngjarjes, gjë që, është vërtetuar përveç deklaratës së dëshmitarit A.K.2, e cila ka mbështetje të plotë edhe në provat materiale si ekspertizën mjeko-ligjore, nga e cila vërtetohet vendi dhe pozita e nga e cila lëndimet janë shkaktuar, e që përputhen plotësisht edhe me deklaratën e dëshmitarit A.K.2, pastaj, edhe të deklaratave të dëshmitarëve V.H. dhe F.L., por edhe dëshmitarit F.S., i cili vërteton se i akuzuari K.K., ka qenë prezent ditën kritike, që do të thotë se demantohet mbrojtja e të akuzuarit se nuk ka qenë fare në vendin e ngjarjes. Po ashtu, përveç deklaratave të dëshmitarëve edhe nga provat materiale e sidomos ekspertiza mjeko-ligjore dhe ajo e balistikës demantohen po ashtu mbrojtja e të akuzuarit se ditën kritike familja K., ka qenë e sulmuar dhe se të njëjtit – pra, i mituri J.K., ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, ngase, sikur që u tha më lartë, nga provat materiale vërtetohet se tani i ndjeri ka qenë i qëlluar me armë zjarri nga prapa – pra, në shpinë, e jo pra, në sulm të drejtë për drejtë, sikur që pretendohet pra, edhe nga mbrojtja e të akuzuarit K.K..

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e cekura si më lartë, si dhe rrethanat dhe arsyerat më detajisht të cekura në aktgjykimin e ankimuar, rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se i akuzuari K.K., ka kryer veprën penale të vrasjes, nga nen 146 të KPK-së, është i drejtë dhe se në mënyrë të pa dyshimtë është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarr të gjitha veprimet inkriminuese të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor, prandaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, ngase, me asnjë provë të proceduar në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk vërtetohet se i akuzuari ka vepruar në mbrojtje të nevojshme sikur që pretendohet në ankesë.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke pasur parasysh rrethanat e vërtetuara e në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit të akuzuarit K.K., ndërsa, të miturit shqiptimin e masës së mbikëqyrjes nga organi i kujdestarisë për veprat e kryera penale, e në të cilat thirren në

arsyetimin e aktgjykimit, e duke i vlerësuar të njëjtat – pra, rrethanat në fjalë përkitazi me pretendimet ankimore, kjo gjykatë i gjen si të bazuara pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit K.K., për shqiptimin e dënimit më të butë me burgim se sa dënimet që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, ndërsa, të pabazuara pretendimet e prokurorisë për shqiptimin e dënimit më të ashpër për të akuzuarin K.K., si dhe po ashtu, të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të miturit J.K., për anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Në ankesën e prokurorisë, përkitazi me këtë bazë ankimore theksohet se me rastin e caktimit të dënimit të akuzuarit K.K., gjykata e shkallës së parë, nuk ka vepruar konform kufijve të paraparë për caktimin e dënimit, në rastin konkret, sidomos kur merret parasysh rrezikshmëria shoqërore e veprës penale, mirëpo, më tutje në ankesë vetëm numëron rrethanat lehtësuese dhe rënduese që i ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, e pa propozuar ndonjë rrethanë konkrete rënduese që do të kishte ndikim të drejtë për drejtë në ashpërsimin e dënimit për të akuzuarin K.K.. Ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit K.K., në ankesë përkitazi me këtë bazë ankimore, konstaton se pasi që aktgjykimi i ankimuar është i kundërligjshëm, atëherë, rezulton se edhe vendimi për dënim është i kundërligjshëm, ngase, i akuzuari është dashur të lirohet nga akuza, mirëpo, edhe sikur i akuzuari të ishte kryes i veprës penale prapë se prapë dënimi i shqiptuar është i ashpër, sidomos, kur dihet se në konfliktin në fjalë është plagosur vëllai i të akuzuarit – i dëmtuari Sh.K., pastaj, se familja K., kanë qenë të sulmuar në oborin e tyre, se familja Kastrati, e ka sulmuar edhe më parë, familjen K., e sidomos, nuk është marrë parasysh fakti se i mituri J.K., ka qenë i kërcënuar nga familja Kastrati edhe disa herë më parë dhe mu për këtë e ka ndërprerë edhe shkollimin e rregullt. Mbrojtësi i të miturit J.K., përkitazi me këtë bazë ankimore nuk cekë asgjë shprehimisht, vetëm se konstaton se dënimi është i kundërligjshëm dhe se i njëjti nuk është i arsyetuar sa duhet, prandaj, edhe propozon anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në ankesat e Prokurorisë dhe mbrojtësit të miturit J.K., nuk është paraqitur asnjë rrethanë rënduese apo lehtësuese që do të ndikonte në ashpërsimin e vendimit për dënim për të akuzuarin K.K., apo shqiptimin e ndonjë mase tjetër – pra, më të butë, për të miturin J.K., mirëpo sa i përket pretendimeve të mbrojtësve të akuzuarit K.K., përkitazi me rrethanat lehtësuese, kjo gjykatë konsideron se përveç rrethanave lehtësuese të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, ka edhe rrethana tjera lehtësuese përkitazi me këtë të akuzuar që nuk janë marrë parasysh, sidomos fakti se ditën kritike ngjarja ka ndodhur kryesisht në pronën e familjes K. – ku pra, anëtarët e familjes K., kanë qenë duke punuar në vendet e tyre të punës, se nga ngjarja në fjalë, lëndime të rënda trupore nga të shtëna armësh, ka pësuar edhe vëllai i të akuzuarit – dëshmitari Sh.K., se konflikti ditën kritike ka filluar në mes të miturit J.K. – pra, djalit të akuzuarit K.K., dhe tani të ndjerit A.K.2 dhe vëllait të tij A.K.2, ku pastaj, në konfliktin fizik në fjalë është përfshirë edhe i akuzuari K.K., prandaj, duke vlerësuar realisht rrethanat lehtësuese të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, dhe rrethanat lehtësuese tani të konstatuara nga kjo gjykatë, të akuzuarit K.K., për vepër penale të vrasjes nga neni 146 të KPK-së, i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 10

(dhjetë) vjetësh, kurse, dënimi e shqiptuar me gjobë nga gjykata e shkallës së parë, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, e merr si të vërtetuar, duke konsideruar, kështu, se tani dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga Gjykata e Apelit, është i drejtë dhe i ligjshme, pastaj është në harmoni me intensitetit e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, është në funksion të preventivës gjenerale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPK.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.172/2017, me dt. 05.05.2017

Procesmbajtëse,

Rrezarta Lleshaj

Anëtarët e kolegjit:

1.Xhevdet Abazi

2.Rasim Rasimi

Kryetar i kolegjit,

Abdullah Ahmeti